

Pyetje të shpeshta

Pyetja 1: A mundet një organizatë e huaj të aplikojë në këtë thirrje si Aplikant apo si Bashkë-aplikant?

Përgjigje 1: Referuar Udhëzuesit për Aplikantët, **pika 2.1.1. Pranueshmëria e Aplikantëve**, në mënyrë që të jetë i pranueshëm për të aplikuar për një grant nën këtë thirrje, aplikanti duhet:

1. Të jetë person ligjor;
2. Të jetë organizatë e shoqërisë civile, e rregjistruar si OJF në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar;
3. Të jetë themeluar dhe të veprojë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të njëjtat kritere vlejnë edhe për bashkë-aplikantin, në rast se do të ketë.

Pyetja 2: Sa i përket bashkëfinancimit; a mund të kontribuojë një organizatë e huaj pjesërisht apo plotësisht shumën prej 5%?

Përgjigje 2: Po, bashkëfinancimi prej 5% (pjesërisht apo plotësisht) mund të sigurohet edhe nga një organizatë e huaj. Pagesat në kuadër të projektit, si pjesë e këtij 5% duhet të kryhen nga llogaria e organizatës zbatuese apo bashkë-zbatuese.

Pyetje 3: A ka garanci kjo pronë sa i përket administrimit? A është vlerësuar risku i përdorimit të pronës nga një organizatë për pesë vitet e ardhshme?

Përgjigje 3: Të treja pronat në dispozicion të projektit CAUSE – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale, janë nën administrimin e Agjencisë së Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK). Me urdhër të Ministrit të Financave, autoriteti vendimmarrës për pronat e konfiskuara nga krimi i organizuar, Urdhër Nr.4, datë 8.5.2017 “Për kalimin e pasurive të konfiskuara në dispozicion të projekti CAUSE – Përdorimi i Pronave të Konfiskuar për Sipërmarrje Sociale”, këto prona janë vënë në dispozicion të projektit, për t’u përdorur pa pagesë nga OJF-të që do të rezultojnë fituese nga kjo thirrje për projekt-propozime, për një periudhë 5 vjecare.

Pyetje 4: A do të ketë mundësi organizata fituese të bëjë investime në ambientet e pronës gjatë zbatimit të projektit?

Përgjigje 4: Referuar Udhëzuesit për Aplikantë, **pika 2.2. Pranueshmëria e Kostove, seksioni: Kostot e Pranueshme**, “ato janë të nevojshme për zbatimin e projektit (përfshi kosto ndërtimi për rehabilitimin infrastrukturor të pronës së konfiskuar dhe blerjen e pajisjeve)”, organizata mund të bëjë investime në ambientet e pronës së konfiskuar gjatë zbatimit të projektit.

Të treja pronat e konfiskuara subjekt i kësaj thirrje për aplikime, kanë nevojë për ndërhyrje infrastrukturorë, prandaj inkurajohen aplikantët që të përfshijnë në projekt aktivitete dhe kosto që synojnë rehabilitimin infrastrukturor që do t'i shërbejë zbatimit të projektit, bazuar në një vlerësim real të tyre.

Pyetja 5: A do të duhet të dorëzohet një preventiv nga një ekspert i licencuar për investimin në ambientet e pronës?

Përgjigje 5: Referuar Udhëzuesit për Aplikantë, **pika 2.3. Si të aplikojmë dhe procedurat që duhet të ndiqen**, Aplikimi duhet të përmbajë: a) formën e aplikimit, b) buxhetin; c) kornizën logjike, dhe Dokumentat Mbështetëse, sic përmenden në Udhëzuesin për Aplikantë. Në këtë fazë nuk kërkohet asnjë dokument tjetër shtesë.

Meqenëse buxheti do të jetë subjekt rishikimi dhe vlerësimi nga Komiteti Vlerësues dhe nga Autoriteti Kontraktues, kostot e përfshira në të (përfshi kostot e investimit në ambientet e pronës së konfiskuar) duhet të jenë sa më të detajuara dhe reale, bazuar në një preventiv paraprak, i cili nuk duhet të jetë pjesë e projekt-propozimit në këtë fazë të aplikimit.

Pyetja 6: Çfarë ndodh me pronën pas përfundimit të projektit? A do të mund të jetë në përdorim nga organizata?

Përgjigje 6: Nëse projekti do të garantojë qëndrueshmërinë, organizatat zbatuese kanë mundësinë të paraqesin pranë AAPSK, në përputhje me procedurat e Agjencisë, kërkesë për zgjatjen e kontratës për një periudhë tjetër.

Pyetja 7: A do të përfshihen kostot e auditimit në projekt?

Përgjigje 7: Po, kostot e auditimit nga një auditues i jashtëm **duhet** të përfshihen në projekt. **Budget Line 5.3. Expenditure verification / Audit**, në formatin e buxhetit të Thirrjes për Aplikime.

Pyetje 8: Sa duhet të jetë buxheti i parashikuar sa i përket shpenzimeve administrative dhe atyre për burimeve njerëzore?

Përgjigje 8: Shuma e parashikuar për shpenzime administrative në buxhet nuk duhet të kalojë 5% të Kostove Direkte Totale të Pranueshme. *Budget Line 8. Administrative costs (maximum 5% of 7, total direct eligible costs of the Action)*, në formatin e buxhetit të Thirrjes për Aplikime.

Shpenzimet për burimet njerëzore duhet të jenë në përputhje me numrin e stafit të parashikuar për zbatimin e projektit, angazhimin dhe kohën e parashikuar për secilin prej anëtarëve të stafit në përputhje me aktivitetet e projektit, dhe pagesën e stafit. Parashikimet duhet të jenë realiste, në përputhje me eksperiencën dhe nivelin e pagave të mëparshme të stafit të propozuar për pozicione të njëjta apo të ngjashme.

Pyetja 9: A do të konsiderohen si "Mbështetje financiare për palët e treta", pra një kosto e papranueshme, "Grantet për trajnime"?

Përgjigje 9: Referuar Udhëzuesit për Aplikantë, **pika 2.1.2. Eligibility of Operations, Financial Support to Third parties**, "...aplikantët nuk mund të ofrojnë mbështetje financiare / nën-grantim për palët e treta...", në asnjë lloj forme.